REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË
Komiteti për Politikë e Financa
I.Numër: ***060/01-18230***
Pejë, datë: 26 Shkurt 2021

P R O C E S V E R B A L

Nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa i KK Pejë, mbajtur me 26 Shkurt 2021, në ora 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Drejtoresha e DKRS-së znj. Xhenete Syka Kelmendi, znj. Anela Hukic Zyrtare Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Pandeli Rugova, shefi i Zyrës Ligjore, z. Avni Gashi zyrtar administrativ në Sektorin për punë të Kuvendit, asistente administrative e Kryesuesit znj. Mire Mujaj, dhe përfaqësuesit e ZIP.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi dr. Islam Husaj.

Kryesyesi e hapi dikutimin për rendin e ditës, ku i sqaroj pikat të cilat janë vendos në rend dite.

z. Nazmi Krasniqi: mendoj se ish dashte me qenë këtu Kryetari i Komunës mbasi si pikë është raporti i punës së SHCK-al për vitin 2020 ose dikush nga drejtorët, pastaj nuk është as nga prokurimi sepse edhe kjo është pikë e rendit ditës realizimin i Planit të Prokurimit për vitin 2020, ndërsa sa i përket pikave për emërtimin e fushave të basketbollit dhe tenisit na ne material nuk keme asnjë biografi për ta edhe pse kemi respekt për këto figura, pra nuk janë kushtet me u

mbajtë ky takim dhe jam kundër; edhe materialet po na vin me vonesë jo ashtu siq është paraparë me rregullore dhe me ligj

Kryesuesi dr. Islam Husaj: këto janë pika informative dhe kemi mundur mos me i pru në KPF por vetëm në kuvend, por për shkak të korrektësisë i kemi pru me u diskutu edhe këtu.

Znj. Mevlyde Idrizi: shpesh drejtoret e komunes nuk përgjigjen në kërkesa tona dhe pasi të kalon afati thot kjo qështje nuk është pëer drejtorin tonë.

Me 8 vota pro dhe 1 kundër u miratu ky:

REND DITE

1. **Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**
2. **Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa: dt. 21 Janar 2021.**
3. **Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e SHCK:**

3.1. Shqyrtimi i Raportit të punës së SHCK-al për vitin 2020.
3.2. Shqyrtimi i Raportiti informativ mbi realizimin e Planit të Prokurimit për vitin 2020.
3.3. Shqyrtimi i Raportit Informnativ mbi procesin e legalizimit në Komunën e Pejës.
3.4. Shqyrtimi i Raportit informative mbi inspektimin e ndërtimeve në Komunën e Pejës.
3.5. Shqyrtimi i Raporti informativ për procesin e kthimit dhe riatdhesimit.
3.6. Shqyrtimi i propozimit të kryetarit të Komunës për emërimin e fushës së basketbollit me emrin e dëshmorëve Adem e Bakir Gjuka, nga Peja.
3.7. Shqyrtimi i propozimit të kryetarit të Komunës për emërimin e Fushës së tenisit në f.Brestovik, me emrin Arben Zeka.

4. **Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.**

I.

Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Në takim, ishin prezent të gjithë anëtaret e KPF-së.

II.

Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa: dt. 21 Janar 2021

Procesverbali nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa: dt. 21 Janar 2021, u miratua unanimisht pa asnjë vërejtje.

III.

Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e SHCK-së:

3.1. Shqyrtimi i Raportit të punës së SHCK-al për vitin 2020.

Kryesuesi dr. Islam Husajt: kryetari tha se këtë raport do ta prezantoj në kuvend.

z. Nazmi Krasniqi: është një raport me shum faqe, por është interesant se dikush nga drejtoritë i ka shkru aktivitetet në detale ndërsa dikush krejt raportin e ka në një faqe, një laramani e quditshme në këtë raport, gjysmën e këtij raporti e ka vetëm DSH; pra edhe pse është raport informativ na edhe këtu edhe në kuvend duhet me diskutu se ku janë mangësitë, a janë kry punët ashtu si duhet; pastaj të ndërtimi i kanaleve të ujitjës në disa fshatra, krejtë janë të përfshira në një vlerë dhe në një rresht, ndërtimi i kanalit ujitjës Qallapek – Buqan projekt dy vjeqar, aty është tu u shti përroj në kanal, nuk ka të bëjë asgjë me ujitje, rregullimi i përrojeve i kalon DKSHP e jo D. Bujqësisë, pastaj e kan zvoglu gjërsinë e shtratit nga 4 metra në 0.80 cm; pra krejt këto pun që janë bo e kap vlerën 567.000 euro, 256.000 euro kanë tepru prej planifikimit, ku janë shku këto mjëtë që kanë tepru?.

Dr. Zize Hakaj Veselaj: DSH-ja i kishte paraqitur në mënyr detale të gjitha punët, këtu thuhet se është bërë dezinfektimi permanent i QMF-ve, por unë e di që vetëm një herë është bërë ky dezinfektim, të participimi jemi dal Ambulanta ma e mirë na në Raushiq; dy konkurse që janë hap janë pranu teknik stomatolog, teknik laburant, mjek të përgjithshëm, por pse nuk po ka konkurse për stomatolog sepse edhe është nevoja edhe e kemi karrikën stomatologjike; ndërsa të shpenzimet 46 servisime me vlerë prej 27.000 euro për një vit.

Kryesuesi dr. Islam Husaj: nuk ka nevoj me shpallë konkurs publik për stomatolog sepse ka shum, por është qështja të sistematizimi i tyre nëpër vende të punës dhe duhet me u shprenda nëpër ambulanta aty ku nuk ka.

3.2. Shqyrtimi i Raportiti informativ mbi realizimin e Planit të Prokurimit për vitin 2020.

Kryesuesi dr. Islam Husaj: kam kërku nga shefi i zyres prokurimit me qenë prezent, ai ka thënë që vjen kryetari por as kryetari nuk ka ardhe, edhe ky është raporti informativ dhe besoj që në kuvend kryetari do ta prezantoj.

Z. Nazmi Krasniqi: ka shum vend për verejtje dhe diskutim për këtë raport, kish qenë mirë që edhe këto kontrata që janë lidh me na tregu se a janë zbatu, nese jo atëher cilat janë masat që janë ndërmarr ndaj kompanive gjegjëse.

z. Gëzon Berisha: për 2020 nuk mundesh me marrë masa ndaj kompanive për shkak te covid 19, sepse ka raste ku kompanit janë dënuar se pse po punojnë gjatë pandemisë.

z. Nazmi Krasniq: nuk pajtohna hiq me këtë qka e tha Gëzoni sepse kompanit e ndërtimit kanë qenë të parat të cilat jan leju me punu.

3.3. Shqyrtimi i Raportit Informnativ mbi procesin e legalizimit në Komunën e Pejës.

Kryesuesi dr. Islam Husaj: ne vitin e kaluar ka fillu legalizimi i objekteve, shtepive private, por nuk është e knaqshme sepse njerzit të cilët po aplikojnë nuk i kan objektet në pronat e tyre, sigurisht që na njofton drejtori në seanc; objektet e kategorisë dytë që janë objekte afariste edhe disa banimi 2 euro është legalizimi për m2, ndërsa kategoria parë shtëpitë private ato janë nga 1 euro për m2.

z. Nazmi Krasniqi: të të hyrat kjo drejtori e ka tejkalu pesëfish, por mbasi nuk është drejtori këtu nuk po e trajtojn këtë pikë.

3.4.Shqyrtimi i Raportit informative mbi inspektimin e ndërtimeve në Komunën e Pejës.

Znj. Mevlyde Idrizi: që një vit e kanë rrethu një vend në lagjen time për me i hekë ato mbeturina por ende nuk kanë ardhur.

3.5.Shqyrtimi i Raporti informativ për procesin e kthimit dhe riatdhesimit.

Znj. Anela Hukic: në raport i kemi dy prioritete, procesin e riatdhesimit dhe procesin e kthimit, të parin gjatë vitit 2020 e kemi pas në sistem online ku i kemi patur 16 raste, disa janë individual e disa me familje, që gjithsejte kanë qenë 29 përsona, secila kërkesë që është bërë ne e kemi verifiku në teren; për riatdhesim gjat vitit 2020 i kemi patur pesë komisione të cilat i kanë shqyrtuar 15 raste, për akomodim me qera janë 8 raste që janë aprovu, trajtim më barrna 2 raste, si dhe për dru për nxemje 5 kërkesa të cilat janë aprovu; për riatdhesim kemi bashkëpunim me Entin për Punësim dhe UNDP, ku në këtë program kemi patur 17 të interesuar; të procesi i kthimit i kemi 10 kërkesa të reja por për shkak të pandemisë ky proces është ndërprerë, për kthim janë ndërtuar 3 shtëpi (2 për serb dhe 1 për boshnjak) që janë aprovuar në 2019-tën.

z. Nazmi Krasniqi: numri i familjeve të riatdhesuara 8, ndërsa numri i të riatdhesuarve 9 përsona, pak quditshme, a e ka kuptimin një anëtar një familje?; na e kem diskutu edhe me herët duhet patur kujdes se nese ka raste që dojnë më u kthy e ata e kan patur pronën dhe e kan shitur, tani ne me ju mbaru shtëpi nuk bënë, duhet patur kujdes.

Znj. Anela Hukic: kshtu ka qenë e cekne në sistem online, unë thash se ka edhe raste individuale edhe me familje; në programin e riatdhesimit në nuk bëjmë ndërtim por rindertim nese posedon dokumentacion që e ka pasë shtëpinë.

Znj. Mevlyde Idrizi: pse u dashtë me qenë 5 komisione në vitin 2020?.

Znj. Anela Hukic: kjo varet prej kërkesave se sa janë, aq kërkesa aq komisione, ose ma mir ta themi komisioni u mbledh pesë herë për pesë raste; po e kemi problem në mbledhjen e komisionit sepse po mungojnë drejtorat.

3.6. Shqyrtimi i propozimit të kryetarit të Komunës për emërimin e fushës së basketbollit me emrin e dëshmorëve Adem e Bakir Gjuka, nga Peja.

Kryesuesi dr. Islam Husaj: e kemi nje konkluzion nga zyra e kryetarit me propozim të DKRS-së, i rekomandohet KPF-së me shqyrtu dhe me dergu në Kuvend emërtimin e fushës së basketbollit afër Xhamisë së Gjylfatimit, me emrin e deshmorëve "Bakir dhe Adem Gjuka".

Znj. Xhenete Syka Kelmendi: ka dy muaj që e kemi pranuar këtë kërkesë nga komuniteti i lagjës, ne pastaj e kemi zhvilluar protokolin e duhur dhe ata i kanë sjell mbi 200 nënshkrime dhe ta përgadisin CV-në dhe arsyetimin e kërkesës së tyre, të gjithë materialin e duhur e kemi dërgu të zyra e kryetarit por për zhkak të angazhimeve të shumta nuk i paskan sjellur këtu por besoj se për kuvend do të jetë materiali i dërguar nga zyra e kryetarit. Bëhët fjalë për një fushë basketbolli që është investim i Kuvendit Komunal, por që nuk është e standartizuar ashtu si parashihet por më shum është si pjesë rekreative.

Kryesuesi dr. Islam Husaj: kjo kërkesë nuk i plotëson kushtet ligjore, fjala është për një hapësirë që është i vendosur një kosh i basketbollit për me luajtur fëmija në lagje, kjo është vendosur në rrugën "Bakir dhe Adem Gjuka" dhe ky kosh i përket hapsirës së kësaj rruge, dhe të gjitha elementet e kesaj rruge janë të emërtuara në vitin 2011 me "Bakir dhe Adem Gjuka", në aspektin procedural për tu emruar një objekt apo një rrugë duhet të jetë e regjistruar si objekt urbanistik, kjo fushë nuk është e regjistruar si objekt urbanistik i cili duhet ta ketë edhe kodin e vete dhe duhet të jëte i regjistruar në hapsirat publike të komunës, pastaj edhe rruga e ka këtë emër dhe me ligjin për sistemin e adresave dhe me UA për adresa nuk lejohet të ketë dyfyshim të emrave, dhe në qoftë se kjo fushë regjistrohet si objekt urbanistik atëher duhet me vendos se a deshirojm me ja lenë këtë emër fushes apo rrugës sepse nuk bënë të dyjat më të njejtin emër, pastaj në bazë të këtij UA parashihet që këto kërkesa të kalojnë nga komisionet përkatse ku të ne është komisioni për emertimin e rrugeve, rrugicave dhe sheshëve; ndërsa UA tjetër i vitit 2019, neni 5, pika 1.9 thot se emri i njejtë në zona të ndryshme nuk lejohet, pra unë mendoj se është nënqmim ndaj këtyre dy deshmorve me që me ja hek emrin e rrugës dhe me ja qitë një koshi, pra ka shum objekte tjera meritore që mundem me ja ngjitë këtë emër; unë jam i obliguar që me jau sqaru se

si shkon kjo pocedur sepse çdo emertim të ri e dergojm në ministri dhe ata këtë na kishin kthy negativ.

z. Nazmi Krasniqi: pajtohna plotësishtë me atë që e tha kryesuesi, pastaj edhe materiali nuk është i kompletuar, dhe qka është me e rendesishmja kjo qështje duhet të shkoj në komisionin për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, është gjynah me i malltretu njerzit me mbledhë nënshkrime pa e ditë procedurën; nuk e di nesë ky komision është ende funksional por një pjesë të fajit e ka edhe kryetari sepse heren e fundit na tha se duhet me berë nje takim me Agjencionin Kadasdral me pa se cilat rrugë i pranojnë e cilat jo, pra nuk na ka informu më se a u taku a jo, si dhe e shoh se po qiten tabelat nëpër rrugë individualishtë që nuk kanë kalu në kuvend.

Znj. Mevlyde Idrizi: sa kame qenë anëtare e komisionit të kaluar ka patur njerz që na kanë qitë ne lajthitje se janë nënshkruar në dy pëticione për të njejtën qështje, për problemet e komisionit parë i kam thënë të gjitha qka i kamë ditë, ndërsa për këtë komision nuke di se deri ku ka shku puna?.

z. Atdhe Berisha: pra në bazë të UA nuk lejohet dyfishimi i emrave qoftë për rrugë, sheshe apo rrugica, kjo është arsyeja parë që bjen kjo qështjë, ndërsa arsyeja e dytë është se duhet ti drejtohen komisionit të emertimit të rrugëve dhe shesheve; ndërsa sa i përket komisionit ne e kemi kry punën si komision, ne kemi patur takim me Agjencionin Kadasdral ata kanë kërku që unë me ju drejtu me një shkres atyre dhe ata kanë kthy pergjigje, na si komision i kem shqyrtu mbi 500 kërkesa për emertime, në fillim kam mendu që kem me patur ma leht si komision mirpo nuk po vine komplet anëtaret në takime, sa i përket asaj që po qesin tabela privatishtë nuk është detyr e komisionit me dal e me ju thonë secilit mos qitni, ajo qështje është e institucioneve tjera; dy here kemi tentu me dergu materialin tonë për KPF dhe kuvend, mirpo mire qe nuk e kemi dergu se prap kemi hasë në probleme dhe manipulime sepse ne kemi bashkëpuni me kryetar të bashkësive lokale dhe disa paleve ata ju kan jap nënshkrime pastaj me kan telefonu e me kanë thëne gabim ja kam ep nënshkrimin pra na kanë qitë në lajthitje; pra unë mendoj na si komision duhet me i kry vetem kto emertimet në rrugë që janë mbete vetem si qështje teknike dhe ato emertime qe nuk kanë probleme, ndërsa ato që kanë probleme me i lanë anash për nje kohe.

Pjese e këtij procesverbali është edhe audioincizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk pat, kryesuesi dr.Islam Husaj, e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:50 h.

Procesmbajtësi,
z. Avni Gashi

K R Y E S U E S I ,
Dr. Islam Husaj